

PRANUAR ME: 23.07.2026  
ACCEPTED ON: 23.07.2026  
PRIMLJENO: 07/158  
Nr. Nr. Nr.:



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E MALISHEVËS  
Drejtoria e Inspektoratit

|        |                                                                                                    |
|--------|----------------------------------------------------------------------------------------------------|
| DATE   | 23/07/2026                                                                                         |
| PËR:   | z. Ekrem KASTRATI , Kryetar i Komunës                                                              |
| NGA:   | Jakup GASHI, Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit                                                 |
| LËNDA: | Raport i Punës së Drejtorisë së Inspektoratit për periudhën kohore prej 01/01/2026 deri 30/06/2026 |

I nderuar,

Bashkangjitur gjeni Raportin e Punës të përgjithësuar të Drejtorisë së Inspektoratit për periudhën kohore Janar –Qershor 2026.

Në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit funksionojnë këta sektorë:

1. Shefi i Drejtorisë
2. Sektori i Tregut
3. Sektori i Ndërtimit
4. Sektori i Ambientit
5. Sektori i Komunikacionit
6. Sektori i Shërbimeve Publike

Drejtoria e Inspektoratit gjatë këtyre muajve ka bërë inspektimin e terrenit në përgjithësi tek të gjithë sektorët.

Gjatë këtyre muajve jemi angazhuar maksimalisht që detyrat dhe përgjegjësit e tona t'i zbatojmë dhe njëkohësisht ti përfundojmë me përpikëri dhe në afat kohor optimal.

Kemi bërë planifikimin e punëve për drejtori për vitin 2026, kemi bërë vlerësimin e punëtorëve për vitin 2025, kemi bërë Raportin e punës për drejtori për vitin 2025 dhe të gjitha këto i kemi dorëzuar tek kryetari.

-Ne ditët e para të fillimvitit në komunën ton ka pasur vërshime në disa lokacione si në qendër të Malishevës ashtu edhe në shumë fshatra të saj dhe me këtë rast ne si drejtori kemi qenë të angazhuar non stop në shtabin komunal për emergjencë

-Pas shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave të natyrave të ndryshme nga qytetarët Drejtoria e Inspektoratit në kohën sa më të shkurt i kemi shqyrtuar këto ankesa dhe sipas nevojës së tyre me pastaj edhe i kemi adresuar

-Në bashkëpunim edhe me Inspektorët e Mjedisit të MMPH-Prishtinë kemi inspektuar disa lokacione të ndryshme dhe më pastaj ne jemi marr me çështjen e një subjekti afarist i cili merret me grumbullim të hekurit dhe pas masave dhe vërejtjeve tona kjo problematik është zgjidhur

-Ne bashkëpunim me Policin kemi inspektuar pikat e grumbullimit të mbeturinave inerte që më herët janë të caktuara nga kuvendi komunal si dhe shumë lokacione tjera të mbeturinave inerte dhe komunale.

-Me rastin e fillimit të aksionit për pastrim të ambientit me moton “ Për Malishevën e pastër” kemi marr pjesë intensivisht në këtë kampanje për pastrim të ambientit si dhe njëkohësisht kemi bërë inspektimin në përgjithësi të terrenit për ruajtjen e ambientit, ku në disa raste kemi shqiptuar gjoja të ndryshme për ndotësit e ambientit.

-Me rastin e marrjes se pëlqimeve nga disa subjekte afariste për hapjen e hyrjeve nga rrethoja të bizneseve direkt në oborrin e QKMF, disa subjekte kanë bërë dëmtim të rrethojës dhe janë vonuar ta bëjnë kthimin në gjendjen e mëparshme të rrethojës, ne kemi dhënë urdhëresë për rregullimin e rrethojës dhe brenda afatit të urdhëresës kanë bërë rregullimin e rrethojës.

-Në bashkëpunim me Policinë e Malishevës, Inspektorët e ATK-së dhe Doganën e Kosovës kemi bërë mbylljen e një subjekti afarist i cili ka qenë duke përdorur aparata për lojëra të fatit, ku këto aparata janë konfiskuar nga Dogana.

-Ne bashkëpunim me Policinë e Malishevës kemi inspektuar dy gurrthyes në komunën tonë lidhur me kushtet e përgjithshme të operimit të tyre.

-Kemi inspektuar transportin rrugor në përgjithësi lidhur me respektimin e vijave të lejuara urbane, me këtë rast kemi konstatuar se tri kompani në relacione të ndryshme nuk janë duke i mbajtur vijat e rregullta urbane, ne kemi bërë Rekomandim Drejtorisë së Shërbimeve Publike për Revokimin e këtyre vijave të lejuara urbane dhe pas rekomandimit tonë ato vija urbane janë anuluar/revokuar.

Kemi inspektuar dhe ndaluar transportin ilegal kryesisht të kombi taksive dhe taxive, dhe kemi shqiptuar gjoba mandatore për kombi taxi ilegal si dhe kemi pasur rast që kemi bërë konfiskimin/ndalimin kombitaksit për 48 orë nga qarkullimi rrugor.

-Janë inspektuar shumë biznese/subjekte afariste për respektimin e përgjithshëm të kushteve të tregut, për mbrojtjen e konsumatorit si: dallimet e çmimeve raft/arkë, për gjendjen rreth kushteve të ruajtjes së mallrave ushqimore, janë kontrolluar edhe mallrat në përgjithësi në theks të veçantë për afatin e skadencës së mallit, vendosjen e flamujve të origjinës së mallit

-Janë inspektuar të gjitha furrat e bukës në territorin e komunës sonë për të verifikuar pastërtinë e ambientit, kontrolluar rreth peshës së deklaruar të bukës dhe gjera tjera sa i përket kësaj fushe veprimtarie.

-Kemi inspektuar dhe njëkohësisht kemi dhënë Pëlqime të ndryshme disa subjekteve afariste për plotësimin e kushteve minimale-teknike për zhvillimin e aktivitetit të subjektit afarist.

-Në bashkëpunim me kompaninë për mirëmbajtje të pastërtisë me rastin e bllokimeve të kanalizimeve në disa lokacione nëpër fshatra kemi bërë deblokimin në shumë lokacione të fshatrave të komunës.

-Jemi duke inspektuar vazhdimisht ndërtimet të cilat kanë Leje Ndërtimore se a janë duke e respektuar ndërtimet e zhvilluara sipas lejes së dhënë.

Zakonisht inspektohet faza e ndërtimit para hedhjes së betonit në pllakë lidhur me respektimin e standardit të ndërtimit/armaturës, po ashtu inspektohet edhe faza e betonimit të shtyllave të objekteve si dhe piketimet e objekteve.

Janë shqyrtuar më shumë se 60 kërkesa të inspektimeve të ndërtimit.

-Është inspektuar terreni për ndërtimet pa leje të cilat i kemi hasur dhe kemi bërë ndalimin e mëtutjeshëm të ndërtimit kemi vendosur shirita zyrtar mbrojtës dhe kemi urdhëruar të mos vazhdojnë punimet deri në pajisjen me leje ndërtimore si dhe njëkohësisht kemi dërguar lëndet në organet kompetente të drejtësisë

-Në bashkëpunim me Inspektoret Regjionale të Agjencisë të Ushqimit dhe Veterinës kemi inspektuar në disa lokacione.

-Jemi duke inspektuar hapësirat publike në tërë territorin e komunës, mbikëqyrje në veçanti të theksuar inspektimin në Sheshin e Dëshmorëve dhe bulevardin "I Mazreku" dhe kemi japë urdhëresë që subjektet afariste që parashohin dhe momentalisht janë duke shfrytëzuar hapësirat publike me tavolina jashtë lokaleve të tyre të pajisën me Pëlqime për shfrytëzim të hapësirave publike.

-Pas ngarkesës me Taks komunale për subjektet afariste në Malishevë Drejtoria e Inspektoratit është duke bërë shpërndarjen e Aktvendimeve të Taksës Komunale për subjektet afariste (deri me tani janë shpërndarë afërsisht mbi 450 Aktvendime) dhe do vazhdojmë përsëri me shpërndarjen e tyre

-Zyrtar të Drejtorisë së Inspektoratit kanë marrë pjesë në shumë komisione që janë caktuar, siç është ai për Performancë Komunale, task Forcën për Ambient, si dhe në komisione të ndryshme komunale.

Faleminderit !.